



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot

Jergucat, me ____10.2024

Lenda: **Njoftim për Konsultim me Publikun**

Ne zbatim të nenit 18 dhe nenit 54, shkronja e ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në zbatim të Rregullores së Keshillit Bashkiak Dropull, Për konsultime Publike"

Keshilli Bashkiak dhe Bashkia Dropull do të organizojnë degjësat publike mbi projektaktet e mëposhtme:

Titulli i Projekt-aktit :

- 1. Projekt Vendim "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025".**
- 2. Projekt Vendim "Për miratimin e Paketës Fiskale 2025".**

Propozuesi : *Projekt –aktet janë propozuar nga Kryetari i Bashkisë.*

Sqarime për projekt-aktet : 1- *Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektiveve të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve .*

2- *Paketa fiskale për këtë periudhë parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve, duke marrë në konsideratë:*

- Kapacitetet fiskale të tatimpaguesve
- Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Analiza një për një e çdo takse &tarife, duke parë faktorët që ndikojnë në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Kalendari i konsultimit : *Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me Kalendarin e Konsultimit Publik*

Pjesëmarrës : **Këshilli bashkiak Dropull,**

Nga ana e Bashkisë : **Kryetari i Bashkisë,**

Nënkryetarët,Administratorët e Njesive Administrative,drejtoria e Finances,e te Ardhurarave,Pyjekullota,Urbanistikes,Ndihmes sociale,Burimeve njerezore

Sherbimeve,pergj.zyrave drejtues/punonjës të administratës/ drejtues te tjere te programeve buxhetore.

- **Nga komuniteti :** *Banorët e Bashkisë sipas te gjitha njesive administrative , Shoqata e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe Kryetarët e Fshatrave.*

Qëllimi i këshillimit publik	<i>Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komuniteti, nepermjet ketij keshillimi publik dhe ne zbatim te nenit 18 dhe nenit 54, shkronja “e” te ligjit 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, si dhe ne zbatim te Rregullores se KB Dropull “Per Konsultimin Publik” Kërkon opinionin e qytetarëve dhe grupeve të interesit, perfshire grupet vulnerabel, për draft projektet e PBA 2025-2027 si edhe cilat janë shërbimet qe duhet te prmiresohen per plotesimin sa me te mire te mundshem te nevojave të komunitetit.</i>
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivate të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për

	ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë ka marrë projekt-vendimin e propozuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 18, ka vendosur kalimin e tij në konsultim publik. Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon - A mendoni se prioritetet e investimeve dhe te shërbimeve te parashtruara ne kete draft program buxhetor afatmesem, permbushin pritshmerite tuaja ne lidhje me ato qe ju i mendoni si prioritete? - Nese jo, cilat do te ishin disa nga sugjerimet tuaja te cilat duhet te pasqyrohen ne kete draft program ne menyre qe ky te permiresohet duhe permbushur me mire interesat tuaja?
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<i>Në pamundësi pjesëmarrje në takime, Këshillit mund ti dërgohen rekomandimet me poste ne Adresen: Bashkia Dropull, Keshillit Bashkiak,i” ose nepermjet postes elektronike ne adresen e sekretarit te Keshillit Bashkiak :</i> ouraniakouremenou@gmail.com deri me date 20 /11/2024
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	https://www.bashkiadropull.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomiko-financiare
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<i>Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike. Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</i> 1. <i>Mbajtja e procesverbalit të cdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.</i> 2. <i>Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.</i> 3. <i>Realizimin nga ana e Sekretarit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje.</i>

	4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës. 6. Hartimi i projekt-vendimit të përmirësuar bazuar në rekomandimet e konsultimit publik. 7. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit.
--	--

Kalendari i Konsultimit Publik

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Dropull i Sipërm	14.11.2024	Vrisera	09.00	Takim publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Dropull i Poshtëm	14.11.2024	Sofratike	12.00	Takim publik	bisede
3	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Pogon	21.11.2024	Poliçan	10.00	Takim publik	bisede

Kryetare e Këshillit

Donika Bauci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK**

PROJEKT -VENDIM

**PER MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TE
BASHKISE DROPULL PER VITIN 2025**

Ne mbështetje të nenit 8,pika 2,nenit 9,pika 1.1,shkrojna “b”,nenit 35 pika 1 dheneni54 shkronja”f” **te Ligjit nr.139/2015,date 17.12.2015,**”Per Veteqeverisjen vendore ;**Ligjin nr . 9632** dt.30.10.2006, “Per Sistemin e Taksave Vendore(i ndryshuar); **VKM Nr.132, datë 7.3.2018** “*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*”

Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”(i ndryshuar); **Ligji nr.9975, datë 28.7.2008** “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; **Ligji nr 10279 date 20.5.2010**”Per kundravajtjet administrative”; **VKM nr.632,date 11.06.2009**”Per miratimine tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje”, V.K.M Nr 559 date 29.07.2022”Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenie ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar,per veprimtari ekonomike,si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” ; te **ligjit 9693**”Per fondin kullusor”, **Ligjin nr.107/2014** ”Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit “(I ndryshuar) ;**VKM nr 54. Date 05.2.2014**”Per percaktimin e kritereve,procedures dhe menyres se dhenies me qira ,enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”(I ndryshuar);**Vendimi Nr.1096 date 28.12.2015**”Per miratimin e rregullave ,kushteve e procedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapesires publike” **Ligji nr.8450, datë 24.2.1999** “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; **VKM nr .970 date 02.12.2015**”Per percaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e licensave dhe tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj”(I ndryshuar) **Udhezimit te Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures nr .5627date 18.11.2016**”Per percaktimin e kritereve,rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licensave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rugor te udhetareve brenda vendit”, **ligji.nr 152/2015**” Per Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”.

Kryetari I Bashkise i propozon Keshillit te Bashkise te, miratoje nivelet per taksat dhe tarifat vendore ,administrimin e tyre si dhe penalitetet per shkeljet apo kundervajtjet administrative per vitin 2025 si me poshte :

TAKSAT VENDORE

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi fitimin pe biznesin e vogël
2. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme në të cilën përfshihen
 - Taksa mbi ndërtesat
 - Taksa mbi tokën bujqësore
 - Taksa mbi truallin
3. Taksa e fjetjes në Hotel
4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
6. Taksa e Tabelës

TAKSAT E NDARA

- 1.Taksa e mjeteve te perdorura
- 2.Taksa e rentes minerare
- 3.Te ardhura nga tatami mbi te ardhurat personale

TARIFAT VENDORE

1. Tarifa e Shërbimit për Familjet
2. Tarifa e Shërbimit për Biznesin
3. Tarifa per rregjistrim Biznesi
4. Tarifa për mjetet e transportit
5. Tarifa për dhënie Leje ushtrim aktiviteti
6. Tarifa per pyje dhe kullota
7. Tarifa ne fushen e urbanistikes
8. Tarifa të ndryshme në funksion të Drejtorive dhe Ndërmarrjeve vartëse.
9. Tarifë për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Dropull
- 10.Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike

I.TAKSAT VENDORE

Lloji,baza tatimore,kategorizimet,kestet e pagimit, lehtesite,perjashtimet dhe struktura pergjegjese.

1.1Tatimi i Thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të pageses së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Shkalla tatimore Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

Parapagimi

1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, Gjatë periudhës vjuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

2. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

3. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, të periudhës paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të parashikuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Nëse organet tatimore vlerësojnë dhe kanë të dhëna se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën vijuese tatimore, do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.

4. Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postën Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Me kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesi shkon te zyrat e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, merr "Pullën e tatimit" të kështit, për të cilin ka bërë pagesën. Dizenjot dhe elementet e pullës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesi e vendos pullën e tatimit lart certifikatës së regjistrimit në QKR për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet

kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dhe shpenzimet përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. "Pulla e tatimit" duhet të përmbajë elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin e tyre.

5. Drejtoritë rajonale tatimore bëjnë regjistrimin e arkëtimit tremujor të tatimit, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së tatimit me zyrat e tatimeve të bashkive. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave .

Deklarimi

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe qdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

Administrimi i tatimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor

Administrata Tatimore Qëndrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka ' vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qëndrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave detytore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

Bashkëpunimi

Drejtoria rajonale tatimore njofton bashkinë jo më pak se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi. Bashkitë, kur e gijkojnë të nevojshme, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.

1.2 TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë,

pavaresisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. .

Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- ❖ taksa mbi ndertesat
- ❖ taksa mbi token bujqesore
- ❖ taksa mbi truallin

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nese pasuria e taksueshme krijohet ,tjetersohet ose zhduket brenda kesaj periudhe ,detyrimi i taksapaguesit llogaritet propocionalisht vetem per periudhen e te drejtes se pronesise

A - Taksa mbi ndertesat

Perkufizime:

“**Cmimi Vleresues**”,njesia matese e vleres per meter katror te siperfaqes se ndertimit te pasurise se paluajtshme. Ky cmim mund te jete cmimi i tregut ose cmimi i vleresuar.

“**Ndertese**”,objekti\objektet e ndertuara mbi\nen siperfaqen e tokes ose te lidhura me token dhe qe perfaqeson nje structure ndertimore me nje ose me shume njesi pronesore,e cila eshte object I takses mbi ndertesën sipas percaktimit te dhene ne ligj.

“**Ndertes e paperfunduar**”,objekti ndertimor ne teresi ose\ajo pjese e ndertesës ekzistuese,per te cilin zhvilluesi eshte pajisur me leje ndertimi,por qe nuk ka arritur ta perfundoj ate sipas afatit te percaktuar ne aktin e miratimit te kerkeses per leje ndertimi.

“**Njesi Pronesore**”,ndertesa ose pjese e saj ,e cila eshte ne pronesi\perdorim te individit,te nje personi fizik apo te nje personi juridik,edhe qe eshte e ndare ligjerisht nga pronat e tjera te pasurise se paluajtshme “ndertese”. Njesia pronesore mund te perdoret per qellime banimi ose\ose per verimtari ekonomike etj.

“**Ndarja e njesise pronesore per banim**”,pjesa e njesise pronesore qe perdoret per qellime banimi.

“**Ndarja e njesise pronesore per veprimtari ekonomike**”,pjesa e njesise pronesore qe perdoret per qellim veprimtari ekonomike

“**Perdorues**”, individi ,person fizik ose juridik,qe ka ne perdorim ndertesën\pjesi pronesore per qellim banimi,veprimtari ekonomike apo veprimtari joekonomike,pavaresisht nga fakti nese kjo ndertes\pjesi pronesore ka titull pronesie ose jo.

“Takspagues”,cdo individ ,person fizik ose juridik,vendas ose i huaj pronare,apo perdorues I pasurive te paluajtshme te mesiperme ,ne territorin e Republikes se Shqiperise pavarasisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre ndertesave.

Detyrimi per pagimin e takses pasurise se paluajtshme”ndertese” e kane sipas rastit,pronari,bashkepronari ,sipas pjeses qe zoteron ,apo perdoruesi i pasurise se paluajtshme,per pasurite qe nuk jane pajisura me dokumanta pronesie,personat qe kan aplikuar per legalizim te nderteses,zhvilluesit, te cilet nuk arrijne te mbyllin ndertimin sipas lejes te leshuar nga njesia e veteqeverisjes vendore.

“Vlere e Pasurise”,eshte baza e taksueshme mbi te cilen aplikohet shkalla e takses se pasurise se paluajtshme ndertese\njesi pronesore.Vlera e pasurise llogaritet si shumezim I cmimit per meter katror me siperfaqen e nderteses\njesi pronesore.

“Veprimtari ekonomike”,cdo veprimtari e kryer nga prodhusit,tregtaret ,personat qe furnizojne mallra dhe sherbime perfshire veprimtarine nxjerrse ,industriale, tregtare, te sherbimit,bujqesore dhe veprimtarite profesionale.Veprimtari ekonomike konsiderohet gjithashtu,shfrytezimi I pasurise se trupezuar ose te patrupezuar ,me qellim realizimin e te ardhurave me karakter te vazhdueshem.

- Takses mbi ndertesat i nenshtrohen individet, personat fizike ose juridik,vendas ose te huaj,pronare,apo perdorues te pasurive te paluajtshme ,ne territorin e Republikes se Shqiperise pavarasisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre ndertesave,pervec rasteve kur ne ligj percaktohen ndryshe.
- Takses mbi ndertesat I nenshtrohen personat qe kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve paleje”.
- Takses mbi ndertesat I nenshtrohen zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi per taksen mbi ndertesat llogaritet si shumezim i baze se takses me shkallen e takses mbi ndertesën.
- Taksa vendore mbi pasurine e paluajtshme-ndertese llogaritet si detyrim vjetor I takspaguesit.
- Cmimi referues i shitblerjes se ndertesave qe perdoren per qellime banimi per Bashkine Dropull eshte 27.000 leke per m2, ky çmim reduktohet ne minus 25 per qind,**pra behet 20250lek/m2**
- Cmimi per meter katror siperfaqe ndertimi per ndertesat qe nuk sherbejne per banim eshte si me poste vijon:

1. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimi per veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5(një pike pesë) here më i lartë i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe njesitë tregtare, ku njekohesisht realizohen edhe procese të përziera, prodhim, tregtim ose edhe shërbime me pakice.

2. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimi per parkim të mbuluar dhe bodrume është 70(shtatëdhjetë) per qind e cmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve

3. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimi per parkim të hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, mini futbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për garat e ndryshme sportive të atletikës, motorrike, garave me kuaj dhe të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30(tridhjetë) per qind e cmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

4. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si prodhim, përpunim ose magazinim i lëndëve të para, të gjysmeprodukteve apo produkteve të gatshme industriale, si fabrika, mangazina, depo, silos, mangazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njesive të tregtimit dhe shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50(pesëdhjetë) per qind e cmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës perkatese, sipas qyteteve.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jo publike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

5. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blektori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blektorale është 30(tridhjetë) per qind e cmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës perkatese, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

6. Çmimi per meter katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2(zero pike dy) here më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar në aneksin 1 që i bashkelidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

a) 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim aplikohet ulje 10% behet 0.045%

b) 0.2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike aplikohet rritje +30%, behet 0.26%

c) 30% e shkalles se takses perkatese per te gjithë siperfaqen ndertimore ,per te cilen zhvilluesi eshte pajisur me leje ndertimi dhe nuk ka arritur ta perfundoj ate sipas afatit te percaktuar ne aktin e miratimit te kereses per leje ndertimi.

Persa I perkete kategorise ndertesa qe perdoren ,shfrytezohet per banim nese identifikohet ekzistenca , por nuk arrihet te percaktohet siperfaqja e ndertesës\njesi pronesore,perdoren vlera referuese per siperfaqen si me poshte vijon:

a)100(njeqind)m2 siperfaqe per njesi pronesore,per ndertesat per banim

b)70(shtatedhete)m2 siperfaqe per njesi pronesore per ndertesat per banim te privatizuara me ligjin 7652 ”Per privatizimin e banesave shtetere,te ndryshuar

Persa I perket kategorise ndertesa qe perdoren,shfrytezohet per veprimtari ekonomike nese identifikohet ekzistenca ,por nuk arrihet te percaktohet siperfaqja e ndertesës\njesi pronesore,njesite e veteqeverisjes vendore bejne verifikime ne terren ,per te percaktuar siperfaqen dhe per te llogaritur bazen e takses.

Emertimi	Vlera ne leke / m2	0% mbi shkallën e taksës
Ndërtesa për qëllime banimi.	<u>9.1 lek</u> (20250*0.045%)	-10%
Ndertesa per veprimtari tregtimi dhe sherbimi	<u>79 lek</u> (30375*0.26%)	+30%
Ndertesa per veprimtari industriale,prodhimi,perpunimi,magazinimi	<u>26.3lek</u> (20250*0.26%*50%)	+30%
Ndertesa qe perdoren per bujqesi dhe blektori apo veprimtari mbeshtetese	<u>15.8lek</u> (20250*0.26*30%)	+30%
Ndertisa per parkim te hapur, pishine e hapur,ambiente sportive te hapura	<u>15.8lek</u> (20250*0.26*30%)	+30%
Ndertesa per parkim te mbuluar dhe bodrume	<u>36.9lek</u> (20250*0.26%*70%)	+30%

Afatet e pageses:

Per kategorine “Ndertesa banimi”

Detyrimi vjetor per ndertesa qe perdoren ,shfrytezohen per banim do te shperndahet per periudhen Janar –Dhjetor 2025 dhe do te paguhet me keste, kesti I deri ne 20 Prill,kesti II deri ne 20 Korrik,kesti III deri 20 Shtator dhe kesti IV deri ne 31.12.2025.

Kjo takse do te arketohet nga Agjenti tatimor i perzgjedhur, marredheniet me te cilin rregullohen me kontrate te posacme .

Detyrimi vjetor per kategorine “ Ndertesa qe perdoret,shfrytezohet per veprimtari ekonomike do te paguhet brenda dates 30.06.2025, ne 2 keste .

Kesti I pare paguhet brenda dates 20Prill
Kesti I dyte paguhet Brenda dates 30Qershor

Struktura e ngarkuar per te ndjekur ,llogaritur dhe vjeljen e takses mbi ndertesat, eshte Drejtoria e te Ardhurave prane Bashkise Dropull.

Tatimpaguesi,I cili nuk arrinqe brenda afatit te parashikuar ,te paguaje Shumen e detyrimit tatimor ,detyrohet te paguaje nje gjobe ,te barabarte me 0.06 per qind te shumes se detyrimit te papaguar per çdo dite ,gjate se ciles pagesa nuk eshte kryer .Ne asnje rast ,gjoba nuk llogaritet per nje periudhe me te gjate se 365 dite kalendarike.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) **ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;**
- f) **ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;**
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, **të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse**

Struktura e ngarkuar per vjeljen e takses mbi ndertesen per Biznesin dhe Familjaret, eshte Drejtoria e te Ardhurave prane bashkise Dropull .

B- Taksa per Token bujqesore

Baza e takses mbi token bujqesore:eshte siperfaqja e tokes bujqesore,ne hektar , ne pronesi ne perdorim te takspaguesit. Siperfaqja e tokes ne pronesi percaktohet sipas dokumentave qe e vertetojne ate.Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise, perdoruesi I tokes bujqesore ben nje vetdeklarim te siperfaqes se tokes bujqesore ,prane bashkise ku ndodhet toka.

Niveli I takses caktohet ne leke per hektar .Detyrimi I takses llogaritet si shumezim I nivelit te takses me bazen e tatueshme.

Kategorite minimale te bazes sedhe nivelet treguese takses per çdo kategori paraqitet si me poshte;

Nr.	Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera sipas Ligjit lekë/hektar/vit
1	I	2800 lekë/ha/vit
2	II	2100 lekë/ha/vit
3	III	1400 lekë/ha/vit
4	IV	1350 lekë/ha/vit
5	V	1250 lekë/ha/vit
6	VI	1200 lekë/ha/vit
7	VII	1100 lekë/ha/vit

Klasifikimi sipas kategorive te tokes bujqesore behet nga strukturat e Ministrise se Bujqesise.

Detyrimi per pagese

Taksa mbi token bujqesore eshte nje detyrim vjetor,ku afati I fundit per likujdimin e saj eshte data 31Dhjetor. Kjo takes do te shlyhet ne kater keste.Kesti i i pare brenda dates 20Prill,Kesti i dyte brenda dates 20Korrik,kesti i trete brenda dates 20Tetor dhe kesti I katert brenda dates 31 Dhjetor.

Tatimpaguesi,I cili nuk arrinqe brenda afatit te parashikuar ,te paguaje Shumen e detyrimit tatimor ,detyrohet te paguaje nje gjobe ,te barabarte me 0.06 per qind te shumes se detyrimit te papaguar per çdo dite ,gjate se ciles pagesa nuk eshte kryer .Ne asnje rast ,gjoba nuk llogaritet per nje periudhe me te gjate se 365 dite kalendarike.

-Perjashtohen nga taksa tokat bujqesore qe mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari per pese vitet e para nga çasti i mbjelljes.

-Perjashtohen nga kjo takse personat nen minimumin jetik.

Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj takese eshte Drejtoria e te Ardhurave dhe Agjent tatimor sipas kontrates.

C- Taksa e truallit

Baza e takses mbi truallin eshte siperfaqja e truallit ne meter katror,ne pronesi apo perdorim te takspaguesit dhe eshte detyrim vjetor. Siperfaqja etruallit ne pronesi percaktohet sipas dokumentave qe e vertetojne ate.Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise perdoruesi I truallit ben nje vetedeklarim te siperfaqes se truallit ne perdorim .

Niveli I takses :caktohet ne lek per meter katror.

Detyrimi I takses llogaritet si shumezim I nivelit te takses me bazen e tatueshme

Kategorite minimale te bazes se takses dhe nivelet treguese te takses per cdo kategori minimale, jepen si me poshte:

Klasifikimi sipas qëllimit të përdorimit për takson e truallit	Vlera e takses në lekë /m ² /vit
Truall për qëllime banimi nga individë	0.14 lekë/m ² /vit
Truall për qëllime biznesi	12 lekë/ m ² /vit

Afatet e pageses

